

Vendim nr. 10 datë 20.01.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 20.01.2023 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 10 (S) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: SENERA HOXHA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-284 (61), datë 21.02.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 57, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka marrë pjesë në konkursin e zhvilluar për programet e specializimeve në Universitetin e Mjekësisë (*UM*), Tiranë, duke aplikuar për programin “Kirurgji e

përgjithshme”, në përfundim të të cilit është renditur e 13-ta. Më pas, ajo i është drejtuar me kërkesë UM-së, e cila, me shkresën nr. 203/1 prot., datë 04.02.2015, ndër të tjera, është shprehur se për zgjedhja e fituesve është kryer në përputhje me kërkesat e sanksionuara në kornizën rregullatore të këtij procesi. Në këto kushte, kërkesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin e UM-së ta njohë dhe ta shpallë fituese për programin në të cilin kishte aplikuar.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2234 (80-2015-937), datë 27.04.2015, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e UM-së, Tiranë ta njohë fituese kërkuesen për konkursin e zhvilluar për specializimin afatgjatë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim UM-ja.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1879 (416), datë 28.06.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2234 (80-2015-937), datë 27.04.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs UM-ja.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-284 (61), datë 21.02.2022, ka vendosur prishjen e vendimeve të mësipërme dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Në datën 19.09.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi, si rrjedhojë e zhvillimit të një procesi të parregullt nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

5. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 10 (S) 2022 të Regjistrisë Themeltar, datë 09.11.2022, pasi vlerësoi se kërkesa ishte e paplotë në drejtim të kriterit *ratione temporis* dhe duhej t’i kthehej kërkueses për plotësim për të paraqitur pretendimet e saj në lidhje me këtë element, vendosi kthimin e saj për plotësim të metash brenda 30 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi. Në datën 12.12.2022 kërkesja paraqiti në Gjykatë plotësimin e kërkesës.

II

Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkesja** pretendon se nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i janë cenuar:

6.1. *E drejta e mbrojtjes dhe e drejta për t’u dëgjuar*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka njoftuar për marrjen e vendimit të ndërmjetëm për pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Gjithashtu, ajo nuk është njoftuar as për rekursin, as për zhvillimin e gjykimit, duke sjellë kështu edhe cenimin e së

drejtës për arsim. Sipas saj, pala paditëse, UM-ja, duke iu referuar vendimit të gjykatës së apelit, ka filluar procedurat dhe e ka ekzekutuar këtë vendim.

6.2. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë jo vetëm që nuk ka kuptuar thelbin e çështjes, por ka gabuar në arsytimin e tij, pasi kandidati i renditur i 12-i ka aplikuar për kuota të mbuluara dhe për kuota të lira, gjë që e ka spostuar automatikisht kërkesen. Gjykata e Lartë ka qenë në dijeni të faktit se kandidati i renditur i 12-i nuk ka vazhduar specializimin, por është transferuar në një degë tjetër.

6.3. *E drejta për arsim*, për shkak se kërkesja i ka pasur aftësitë për t'u kualifikuar. Fakti që kandidati tjetër A.P. ka bërë të njëjtin aplikim për kuotën e lirë dhe kuotën e mbuluar, i ka hequr asaj mundësinë për të fituar. Ajo është futur me kuotat e lira dhe nuk ka aplikuar fare për kuotat e mbuluara. Duke qenë se është renditur e 13-a, nëse kandidati tjetër do të kishte zgjedhur vetëm një opsion, automatikisht kërkesja do të ishte futur e 12-a në listë dhe do rezultonte fituese. Ky cenim ka ardhur nga fakti se UM-ja ka lejuar aplikimin me kuota të lira dhe me kuota të mbuluara.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkeses

7. Çështja e legjitimit (locus standi) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

8. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae* për pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në rastin konkret kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe nuk ka më mjete për të shteruar përveç ankimit në këtë Gjykatë.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr.8577/2000, vërehet se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nenet 142, pika 1 dhe 146, pika 2, të Kushtetutës, parashikojnë detyrimin për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe shpalljen publikisht të tyre në çdo rast.

12. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 84, datë 26.12.2017; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja ka përfunduar me vendimin nr. 00-2022-284 (61), datë 21.02.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 19.09.2022, pra dukshëm përtej afatit ligjor.

14. Sipas kërkueses, ajo është interesuar vazhdimisht pranë sporteleve të Gjykatës Lartë për të marrë informacion në lidhje me çështjen dhe i është thënë se vendimi do t'i komunikohet në mënyrë elektronike. Ajo pretendon se edhe pse kishte lënë të dhënat e adresës elektronike, vendimi nuk i është komunikuar në këtë mënyrë dhe për shkak të angazhimeve të saj profesionale ka qenë në pamundësi për të shkuar përsëri pranë sporteleve të Gjykatës së Lartë për t'u interesuar për fatin e çështjes. Në datën 20.06.2022 (4 muaj pas përfundimit të çështjes në Gjykatën e Lartë), kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për informacion për çështjen e saj. Me shkresën nr. 2942/1 prot., datë 28.06.2022, Gjykata e Lartë i komunikoi asaj dispozitivin e vendimit, duke i bashkëlidhur shkresën edhe vendimin nr. 00-2022-284 (61), datë 21.02.2022, objekt kërkesë. Sipas kërkueses, ky është momenti kur është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë objekt kërkesë, dhe prej këtij momenti fillon të ecë afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

15. Në raste të ngjashme Kolegjet e Gjykatës kanë vlerësuar se paraqitja e shkresës së gjykatave, ku kërkuesit janë pajisur me një kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë, nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht për këtë vendim, sepse një informacion i tillë mund të kërkohej në çdo rast dhe në çdo ditë kur një palë ndërgjyqëse kërkon të pajiset me një kopje të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 116, datë 08.10.2021; nr. 126, datë 29.10.2021; nr. 34, datë 21.01.2020; nr. 36, datë 21.01.2020 të Kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se ka qenë UM-ja që ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë dhe kërkuesja ka pasur dijeni për të, pasi, siç pranon edhe vetë në kërkesën e paraqitur në këtë Gjykatë, ajo është interesuar disa herë në Gjykatën e Lartë për fatin e çështjes së saj. Referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se në datën 28.01.2022 është bërë shpallja e çështjes së kërkueses, duke përcaktuar datën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues. Pas shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë e ka publikuar vendimin për çështjen e kërkueses. Gjithashtu, referuar materialeve të dosjes gjyqësore, rezulton se në datën 29.03.2022 sekretaria e Gjykatës së Lartë i ka komunikuar kërkueses vendimin e çështjes së saj në adresën elektronike të lënë nga vetë ajo (avokatrande@gmail.com). Në këtë kuptim, Kolegji çmon se pretendimi i kërkueses për mosnjohim të vendimit nga Gjykata e Lartë është haptazi i pabazuar.

17. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.